

**Nr.52104-00812-00-2010 i Regj.Themel
Nr.00-2011-214 i Vendimit (40)**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Gani Dizdari	Kryesues
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 23.02.2011 mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË GJYKUARIT: TOMOR ÇELA,

A K U Z U A R:

Për kryerjen e veprave penale të
“Vrasjes me paramendim”, të kryer në bashkëpunim,
në dëm të viktimës Elton Dani,
parashikuar nga neni 78 dhe 25 K.Penal;
“Vrasjes me paramendim”
në dëm të viktimës Ledian Hoxha,
kryer në bashkëpunim,
parashikuar nga neni 78 dhe 25 i K.Penal;
“Mbajtjen pa leje të armëve luftarake”,
parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimi nr.272, datë 18.03.2004, ka vendosur:
Të deklarojë fajtor të pandehurin Tomor Qazim Çela, për kryerjen veprës penale të “Vrasjes me paramendim” në dëm të viktimës Elton Dani dhe, në bazë të nenit 78/1 të K.Penal, e dënon atë me 20 (njëzet) vjet burgim.
Të deklarojë fajtor të pandehurin Tomor Qazim Çela, për kryerjen veprës penale të “Vrasjes me paramendim” në dëm të viktimës Ledian Hoxha dhe, në bazë të nenit 78/1 të K.Penal, e dënon atë me 20 (njëzet) vjet burgim.
Të deklarojë fajtor të pandehurin Tomor Qazim Çela, për kryerjen veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” dhe, në bazë të nenit 278/2 të K.Penal, e dënon atë me 1 (një) vit burgim.
Bazuar në nenin 55 të K.Penal “për caktimin e dënimit për disa vepra penale”, i pandehuri Tomor Qazim Çela dënohet në një dënim të vetëm prej 23 (njëzet e tre) vjet burgim.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr.474, datë 25.06.2004, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr.272 datë 18.03.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1120, datë 29.07.2009, ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tomor Çela, për kryerjen veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78/1 i K.P. dhe, në bazë të nenit 78/1 të K. Penal, e dënon atë me 20 (njëzet) vjet burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tomor Çela, për kryerjen veprës penale të “Vrasjes me paramendim”, parashikuar nga neni 78/1 i K.P. dhe, në bazë të nenit 78/1 të K.Penal, e dënon atë me 20 (njëzet) vjet burgim

Deklarimin fajtor të të pandehurit Tomor Çela, për kryerjen veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” dhe, në bazë të nenit 278/2 të K.Penal, e dënon atë me 1 (një) vit burgim.

Bazuar në nenin 55 të K.Penal për caktimin e dënimit për disa vepra penale e dënon të pandehurin Tomorr Çela me një dënim të vetëm prej 24 (njëzet e katër) vjet burgim.

Vuajtja e dënimit do të fillojë me ekzekutimin e këtij vendimi pas marjes formë të prerë të tij.

Provat material, të cilat janë:

1 automatik i tipit kallashnikov me nr. 076597-89.

2 krehëra automatiku me nga 30 fishekë.

1 krehër pushke me 5 fishekë sekuestruar sipas proces verbalit të dates 30.11.1997 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të kalojnë në favor të shtetit.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në gjykatën e apelit.

U shpall në Tiranë, sot më 29.07.2009.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.387, datë 14.05.2010, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1120, datë 29.07.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka bërë rekurs i gjykuari Tomorr Çela, nëpërmjet mbrojtësit të tij, për shkaqet:

- Janë shkelur dispozitat procedurale që kanë të bëjnë me njoftimin e të pandehurit në gjëndje të lirë,dhe për deklarinimin e mungesës sipas neneve 140/2, 2, 4 e 351 të K.Pr.Penale.
- Rezulton nga materialet se nuk i është bërë asnjë njoftim të pandehurit, por gjykata është mjaftuar vetëm me shkresën e policisë që citon se i pandehuri është jashtë shtetit dhe mbi këtë bazë është deklaruar dhe mungesa e të pandehurit.
- Janë shkelur dispozitat procedurale që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar, sipas nenit 15 e 17/c, ë të K.Pr.Penale.
- I njëjti trup gjykues ka caktuar masën e sigurimit dhe ka dhënë vendim fajësie.
- Në arsyetimet e gjykatave janë përdorur procesverbalet e deklarinimit të dëshmitarëve

marrë para organit të prokurorisë dhe jo ato të marra para gjykatës, në kundërshtim me nenet përkatëse të K.Pr.Penale.

- Të dyja gjykatat kanë anashkaluar dëshmitë e dëshmitarëve të akuzës, duke i dhënë përparësi dëshmive të familjarëve të viktimave.
- Masa e sigurimit është marrë pas më shumë se 8 vjetësh nga fillimi i çështjes penale dhe është marrë pas shumë seancave kur në gjykatë ishin pyetur gati të gjithë dëshmitarët.
- Trupi gjykues pra ka shfaqur mendim duke paragjykuar çështjen.
- Gjykata ka shkelur kërkesat e neneve 3, 4 151/4, 152/1 e 380 të K.Pr.Penale.
- Gjatë hetimit gjyqësor nuk është provuar se i pandehuri të ketë disponuar mjet të tipit autoveturë.
- Nga akt ekspertimi i automatikut (të punës) së të pandehurit nuk vërtetohet se ky automatik të ketë shtënë në vendngjarje.
- Në vendngjarje viktimat janë gjetur të armatosur rëndë, por gjykata nuk arsyeton se kush është motivi i grindjes së të pandehurit me viktimat.
- Të gjithë dëshmitarët e akuzës citojnë vetëm se kemi dëgjuar që vrasjen e ka bërë i pandehuri.
- Shokët dhe dëshmitarët e të pandehurit kanë deklaruar në seancë gjyqësore se kanë qenë nën shoqërinë e tij kur ka ndodhur vrasja.
- Edhe shtrëmbërimi që i bëjnë gjykatat rrethanave të çështjes shton bindjen se vendimi është marrë në kundërshtim të hapur me provat e shqyrtuara në gjykatë.
- Kështu, gjykatat shtrëmbërojnë vendin e saktë ku ka ndodhur ngjarja, si dhe ardhjen e të pandehurit në shtëpi, duke cituar nënën e tij (flitet për të vëllain e të pandehurit, kurse gjykatat citojnë të pandehurin).
- Deklarimet e dëshmitarëve para gjykatës përforcojnë faktin se i pandehuri është i pafajshëm.
- Provat indirekte që nuk mbështeten në ndonjë provë direkte nuk mund të shërbejnë për deklarimin fajtor të të pandehurit.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Besnik Imeraj; Prokurorin Bujar Sheshi, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë; av. A.Salati, që kërkoi prishjen e dy vendimeve dhe dërgimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë; dhe si shqyrtoi në tërësi çështjen,

V Ë R E N

Në datë 27.11.1997, rreth orës 20.30, në Lagjen nr.9, Rruga “Bajram Curri”, ndërmjet pallateve 490/7 dhe 490/8, në automjetin me targa CT403167 tip “Volvo” janë vrarë me armë zjarri shtetasit Elton Dani dhe Ledian Hoxha, viktimat janë gjetur të armatosur me armë zjarri.

Sa kanë pranuar të provuar gjykatat e faktit, dy viktimat janë vrarë nga i gjykuari Tomor Çela, banor i Tiranës dhe në atë periudhë ka qenë me detyrë punonjës policie në Komisarjatin e Policisë Nr.4 Tiranë deri më datën 15.06.1997, datë në të cilën ai është liruar nga kjo detyrë. Tre-katër ditë para ngjarjes i pandehuri ka qenë duke udhëtuar me automjetin e tij Benz Mercedes të llojit 240, dhe është përplasur me automjetin që drejtohej nga i ndjeri Ledian Hoxha, në të cilën ndodhej edhe shoku i tij, i ndjeri Elton Dani. Nga incidenti i

mësipërm acarimi i palëve arriti në atë shkallë, sa në datën 27.11.1997 solli ngjarjen për të cilën i pandehuri Tomorr Çela akuzohet. Në datë 27.11.1997 i pandehuri Tomorr Çela i shoqëruar nga disa shokë, si edhe nga vëllai i tij Elton Çela kanë qenë duke pirë në lokalin e dëshmitarit Luan Karaji ku kanë qëndruar deri rreth orës 19.30, orë në të cilën janë vrarë dy viktimat.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka deklaruar fajtor të gjykuarin dhe e ka dënua dy herë sipas dispozitës së nenit 78 e 25 të K.Penal dhe nenit 278/2 të K.Penale. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke gjetur të bazuara në ligj pretendimet e ngritura në rekurs nga ana e të gjykuarit vetëm përse i përket shkeljeve procedurale që lidhen me njoftimin e të pandehurit të lirë, çmon se vendimet e dy gjykatave duhet të prishen dhe çështja të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se gjykimi i çështjes në shkallë të parë është kryer në shkelje të rregullave procedurale që lidhen me thirjen dhe pjesëmarrjen e të pandehurit në gjykim kur ajo ka qenë e domosdoshme, rrethanë kjo që në kuptim të dispozitës së nenit 128/c të K.Pr.Penale e bën vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë një akt absolutisht të pavlefshëm. Kështu, rezulton se me urdhërat e datës 13.06.2006 dhe 29.06.2006 të gjyqtarit R.Hado është urdhëruar kërkimi i të pandehurit Tomor Çela nga organet e policisë, ndërkohë që rezulton e provuar se ky i pandehur në atë periudhë ka qenë i hetuar në gjëndje të lirë, pasi masa e sigurimit arrest në burg ndaj tij është caktuar në datën 21.01.2009. Në rrethanat e mësipërme, duke qenë se i pandehuri Tomor ka qenë në gjëndje të lirë, njoftimi i tij ka qenë i detyruar të kryhej konform rregullimeve që parashikon dispozita e nenit 140 të K.Pr.Penale.

Sipas pikës 1 të kësaj dispozite “njoftimi i të pandehurit në gjëndje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij kopjen e aktit. Kur nuk mund t’i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vëndin e punës duke ja dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton, ose një fqinji ose një personi që punon me të”. Në dosjen gjyqësore nuk ekziston asnjë akt që të tregojë se gjykata e shkallës së parë t’i ketë dorëzuar të gjykuarit Çela kopjen e fletë thirjes, që gjykata fletë thirjen t’ia ketë dorëzuar në banesë apo vëndin e punës ndonjërit prej personave që përcakton dispozita, duke konsideruar kështu të gjykuarin Tomor Çela të pa njoftuar për gjykimin e tij në gjykatën e shkallës së parë.

Në rrethanat kur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është një akt absolutisht i pavlefshëm, në kuptim të dispozitës së nenit 131/1 të K.Pr.Penale, kjo pavlefshmëri bën të pavlefshëm edhe vendimin nr.387, datë 14.05.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, edhe pse nga kjo gjykatë në gjykim janë zbatuar drejt kërkesat procedurale që lidhen me njoftimin e të pandehurit në mungesë.

PËR KETO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441/ç të K.Pr.Penale,

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.387 datë 14.05.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.1120, datë 29.07.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 23.02.2011

